



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V_472_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_833_07_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_833_07_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 31.08.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin R. G. (shifra në KEK: DPZ - 37662), nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_833_06_12 i datës 30.07.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 16.12.2007 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar që konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik si dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4695137.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 21.02.2008 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 4695137 të vendosur nga vet konsumatori si dhe te njehsori i vjetër kanë shënuar se pa njehsor.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 21.05.2008 ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPZ-37662 me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike DPZ08HP04303 në vlerë prej 2,821.13€. Pas kësaj ngarkese konsumatori ka parashtruar ankesë KEK. Departamenti për Konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjegjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 30.07.201 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPZ08HP04303 i datës 21.05.2008 në vlerë prej 2,821.13€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.08.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr.



ZRRE/DMK_V_833_07_12 të datës 30.07.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit për fshehjen e njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e KEK-ut nr. 047876 të datës 16.12.2007 dhe nr. 0023/D të datës 21.02.2008 dhe ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut gjatë inspektimit të parë kanë bërë vulosjen e njehsorit elektrik nr. 4695137 me vulë distributive numër A 20030567, ndërsa tek mbas dy muajve kanë dalur për regjistrim zyrtar të njehsorit elektrik.

Gjatë analizave të bëra listave të leximit të KEK-ut është vërejtur se lexuesi i KEK-ut nga periudha 02/2007 ka konstatuar se konsumatori ka bërë ndërrim njehsori si dhe në disa periudha ka bërë regjistrimin e shpenzimeve mujore me njehsorin e ri elektrik nr. 4695137, por që konsumatori edhe përkundër që është evidentuar se kemi ndërrim njehsori është vazhduar të faturohet për këtë periudhë pa matje/paushall, gjë është një neglizhencë e punëtorëve të KEK-ut mos marrja e masave të menjëhershme për ta regjistruar njehsorin e ri dhe ta faturojë sipas shpenzimeve reale.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e ri elektrik dhe njehsorin e vjetër, dhe është vërejtur se nga periudha 10/2002 deri më 04/2006 nuk ka fare regjistrim të shpenzimit të energjisë elektrike, përkatësisht shifra e konsumatorit DPZ – 37662 ka qenë passive dhe se aktivizimi i saj ka ndodhur me datë 27.04.2006. Pas këtij aktivizimi konsumatori është faturuar me faturim pa matje/paushall, ndërsa në muajin 03/2008 Departamenti I Faturimit në KEK e ka faturuar si shpenzim mujor prej 7,950 kWh e kjo si rezultat i grumbullimit të muajve të meherëshëm.

Bordi ka analizuar edhe një vërtetim nga Drejtoria për Shërbime Publike nga Kuvendi Komunal i Prizrenit nr. 82/08 të datës 10.07.2008 me të cilin vërtetohet se shtëpia e konsumatorit R. G. nga fshati Atmaxhë është i djegur gjatë luftës dhe se personi në fjalë ka rindërtuar shtëpinë me vetëfinancim.

Kundërshtimet e KEK-ut të theksuara në ankesë se konsumatori ka fshehur njehsorin elektrik dhe meqë rast ka bërë veprë penale nga neni 252 i KPK, kanë të bëjnë me elemente të veprës penale dhe se Bordi i ZRRE-së pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës së KEK-ut thekson se ZRRE nuk bënë shqyrtimin e elementeve të veprës penale, por ka shqyrtuar vetëm faturën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të ngarkuar nga KEK-u. Duhet theksuar se gjatë analizës së vërejtur se sipas vërtetimit nga Drejtoria për Shërbime Publike nga Kuvendi Komunal i Prizrenit nr. 82/08 të datës 10.07.2008 se objekti i konsumatorit ka qenë i djegur gjatë luftës dhe se ky është dokument zyrtar. Po ashtu shifra e konsumatorit DPZ – 37662 nga periudha 10/2002 – 04/2006 ka qenë pasive gjë që konstatohet se nuk ka pasur shpenzime të energjisë elektrike, si dhe që nga 02/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se kemi ndërrim njehsori dhe se KEK-u nuk ka ndërmarrë asnjë veprim deri më 03/2008. Po ashtu duhet theksuar se KEK-u nga periudha 04/2006 e deri më 02/2008 e ka faturuar konsumatorin me faturim pa matje/paushall. Bordi i ZRRE-së duke i marrë për bazë të gjitha argumentet e theksuara më lart, konstaton se vendimi i DMK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK-u në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankesë pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_833_07_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar